



**FONDI I SIGURIMIT TË
DETYRUESHËM TE KUJDESIT
SHËNDETËSOR
DREJTORIA RAJONALE _____**

**ORGANIZATA JOFITIMPRURËSE

_____**

Nr. _____ Prot. Datë _____

Nr. _____ Prot. Datë _____

K O N T R A T Ë

**“PËR LËSHIMIN E RECETËS ME RIMBURSIM NGA MJEKËT E
ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE TË LICENCUARA QË
OFROJNË KUJDES PALIATIV, PËR VITIN 2024”**

Ndërmjet

**DREJTORISË RAJONALE TË FONDIT TË SIGURIMIT TË
DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR _____**

Dhe

**MJEKUT TË ORGANIZATËS JOFITIMPRURËSE TË CERTIFIKUAR
NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
PËR OFRIMIN E KUJDESIT PALIATIV**

Kjo Kontratë nënshkruhet në _____, në datë _____

ndërmjet:

Drejtorisë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor _____ (në vijim DRF), e përfaqësuar nga Z/Znj _____, drejtor i DRF _____,

dhe

Mjeku pranë Organizatës Jofitimprurëse _____ Z/Znj. _____ me adresën _____ (në vijim mjeku) ;

më poshtë të quajtuara “Palët”

Dispozita paraprake

Duke qenë se:

A. DRF, janë organe në varësi të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (në vijim Fondi), të cilat e zhvillojnë aktivitetin në bazë dhe për zbatim të Ligjit nr. 10383, datë 24.02.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

B. Në bazë të ligjit të sipërcituar, Fondi lidh kontrata me dhënësit e shërbimit shëndetësor për dhënien e shërbimeve shëndetësore, të përfshira në paketat e shërbimeve si dhe shërbime të përcaktuara me ligje të veçanta;

C. Mjekut i është njohur e drejta për lëshimin e recetës me rimbursim për kujdesin paliativ, në bazë të legjislacionit në fuqi;

D. Këshilli Administrativ i Fondit, ka miratuar kontratën tip “Për lëshimin e recetës me rimbursim nga mjekët e organizatave jofitimprurëse të licencuara që orfojnë kujdes paliativ, për vitin 2024”, me VKA nr. 21, datë 20.12.2023.

palët e mësipërme bien dakord si vijon:

Neni 1

Objekti i Kontratës

Objekti i kësaj Kontrate, është njohja nga Fondi e së drejtës së lëshimit të recetës me rimbursim, nga mjeku i organizatës jofitimprurëse i certifikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për ofrimin e kujdesit paliativ për të sëmurët me sëmundje onkologjike nga momenti i daljes nga spitali e në vazhdim.

Neni 2

Baza ligjore

Për hartimin dhe zbatimin e kësaj kontrate palët i referohen dhe mbështeten mbi bazën ligjore që vijon:

1. Ligjit nr. 10383, datë 24.02.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
2. Ligji nr. 138, datë 16.10.2014, “Për kujdesin paliativ në Republikën e Shqipërisë”;
3. Ligjit nr. 10107, datë 30.03.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
4. Ligji nr. 10138, datë 11.05.2009, “Për shëndetin publik”, i ndryshuar;
5. Ligji nr. 105/2014, datë 31.07.2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, i ndryshuar;
6. Ligji nr. 7975, datë 26.07.1995, “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”, i ndryshuar;
7. Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil”, i ndryshuar”;
8. Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundërvajtje administrative”;
9. Ligji nr. 44, datë 30.04.2015, “Kodi i Procedurës Administrative”;
10. Ligji nr. 49/2012, datë 03.05.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.
11. Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
12. Ligji nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
13. Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
14. Ligji nr. 123, datë 25.09.2014, “Për Urdhërin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë”;
15. Ligji nr. 127/2014, datë 02.10.2014 “Për Urdhërin e Stomatologut në Republikën e Shqipërisë”;
16. Kodi i Etikës dhe Deontologjise mjekësore;

17. Ligji nr. 9718, datë 19.04.2007, “Për Urdhërin e Infermierit në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
18. Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
19. Ligji nr.10237, datë 18.02.2010, “Siguria dhe shëndeti në punë”, i ndryshuar;
20. VKM nr. 124, datë 5.3.2014, "Për miratimin e statutit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
21. VKM nr. 865, datë 24.12.2019, “Për mënyrën e kryerjes së procesit të akreditimit të institucioneve të kujdesit shëndetësor e përcaktimin e tarifave dhe afateve kohore”;
22. VKM nr. 737, datë 05.11.2014, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore publike të kujdesit shëndetësor parësor, nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”;
23. VKM nr. 307, datë 21.05.2014, “Për regjistrimin dhe identifikimin e personave të siguruar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor”, i ndryshuar;
24. VKM nr.101, datë 04.02.2015, “Për miratimin e paketës së shërbimeve shëndetësore në kujdesin shëndetësor parësor publik, që financohet nga Fondi i sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor”, i ndryshuar;
25. VKM nr. 789, datë 22.09.2015, “Për përcaktimin e kriterëve, standardeve dhe procedurave të programit të certifikimit për profesionistë të shëndetësisë”, i ndryshuar;
26. VKM nr. 489, datë 30.07.2021, "Për miratimin e listës së barnave që rimbursohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe të masës së mbulimit të çmimit të tyre”; i ndryshuar,
27. VKA nr. 34, datë 12.12.2019, për miratimin e rregullores “Mbi procedurat e përshkrimit, gjenerimit, ekzekutimit, kontrollit dhe rimbursimit të recetës elektronike e-RX”;
28. Udhëzim nr. 17, datë 23.12.2019 “Për identifikimin e të siguruarve në skemën e sigurimit shëndetësor”; i ndryshuar;
29. Urdhër nr. 657, datë 15.12.2010, i Ministrisë së Shëndetësisë “Për miratimin e kartës shqiptare të të drejtave të pacientit”;
30. Urdhër nr. 450, datë 24.10.2014, i Ministrisë së Shëndetësisë “Për miratimin e protokolleve klinike të kujdesit paliativ”;
31. Urdhër nr. 37, datë 25.01.2017, i Ministrisë së Shëndetësisë “Për miratimin e listës së sëmundjeve kronike”.
32. Urdhër nr. 493, datë 02.07.2019, “Për sistemin e referimit dhe tarifat e shërbimit shëndetësor publik” i ndryshuar;
33. Udhëzim nr.14, datë 11.11.2019, “Mbi procedurat për pajisje dhe revokim me nënshkrimin elektronik të profesionistëve të shëndetësisë të punësuar në institucionet shëndetësore publike dhe subjektet farmaceutike me kontratë me Fondin”.
34. Udhëzim Nr.11, datë 22.09.2023, “Për regjistrimin elektronik të të siguruarve pranë mjekut të përgjithshëm dhe të familjes”;

Neni 3

Detyrime të përgjithshme të mjekut

1. Të ofrojë shërbime shëndetësore në banesë sipas nevojës për kujdesin paliativ për të sëmurët me sëmundje onkologjike në status të avancuar dhe shumë të avancuar.
2. Shërbimet shëndetësore duhet të ofrohen, në përputhje me Ligjin për Kujdesin Shëndetësor, Ligjin për Barnat, protokollet profesionale të miratuara, Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjeksore, Urdhërin e Mjekut dhe Urdhërin e Infermierit, si dhe legjislacionin për sigurimet shëndetësore.
3. Të regjistrojë në një regjistër të veçantë të gjithë të sëmurët që përfshihen objekt i kësaj kontrate dhe t'u hapë kartelë personale atyre, kundrejt rekomandimit të Mjekut të Përgjithshëm dhe të Familjes (në vijim MPF) dhe epikrizës dalëse nga shërbimi onkologjik i QSUT.
4. Të kryejë vizitën falas, kundrejt identifikimit të pacientëve nëpërmjet dokumentit të identifikimit, si dhe të plotësohet dokumentacioni përkatës, regjistri i vizitës, kartela, me të dhënat e domosdoshme.
5. Të referojë të sëmurin, duke zbatuar sistemin e referimit, në konsultën e specialistëve të spitalit, në rastet kur e gjykon të nevojshme dhe në zbatim të ligjshmërisë me akte të veçanta të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (në vijim MSHMS) dhe Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
6. Të japë informacion në DRF për aktivitetin e kryer objekt i kësaj kontrate sa herë që kërkohet.
7. Të pranojë kontrollin nga Fondi/ DRF dhe MSHMS/Operator.
8. Mjeku duhet të jetë i licencuar dhe me licencë të vlefshme, të bazuar në ndjekjen e vazhdueshme dhe përmbushjen e kërkesave të Edukimit Profesional në Vazhdim.

Neni 4

Detyrimet e mjekut për lëshimin e recetës me rimbursim

1. Të plotësojë recetën elektronike, vetëm për banorët me sëmundje onkologjike dhe onko-hematologjike në stadet e avancuara dhe shumë të avancuara.
2. Të plotësojë saktë të gjithë elementët e recetës elektronike sipas kërkesave të programit eRx dhe udhëzimeve të Fondit.
3. Në recetat pa rimbursim të plotësohen elementët e domosdoshëm të përcaktuar nga MSHMS: emër dhe mbiemër pacienti, datëlindje, nr. regjistri të vizitës, diagnozë, datë vizite, vulë dhe firmë mjeku, si dhe vulë institucioni.

4. Në recetat me rimbursim të përshkruajë vetëm barnat që janë të përcaktuar për mjekimin simptomatik dhe të antidhimbjes të trajtimit të sëmundjeve onkologjike dhe onkohematologjike në stadet e avancuara dhe shumë të avancuara.
5. Të plotësojë receta për çdo diagnozë, duke vendosur diagnozën dhe të përshkruajë aq barna sa duhen për trajtimin e të sëmurit në afate sipas ecurisë së gjendjes së të sëmurit duke mos dublikuar mjekimin.
6. Të përshkruajë barnat në recetën elektronike në përputhje me diagnozën.
7. Të lëshojë recetë të veçantë për barnat narkotike dhe psikotrope.
8. Të përdorin nënshkrimin elektronik të recetës elektronike, të vulosin me vulën personale recetën pa rimbursim, si dhe të mbajnë përgjegjësi për zbatimin e të gjitha rregullave lidhur me ruajtjen dhe përdorimin e vulës së tyre personale dhe të nënshkrimit elektronik.
9. Në rastet e ndërprerjes së kontratës, mjeku duhet të finalizojë paraprakisht të gjitha recetat e panënshkruara përpara largimit të tij.

Neni 5

Detyrimet e Drejtorisë Rajonale të Fondit

1. Të pajisë Mjekun me Listën e Barnave, protokollet e përdorimit të barnave, recetat tip me rimbursim dhe aktet normative të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit të tij në zbatim të kontratës.
2. Të sqarojë Mjekun për çdo paqartësi lidhur me listën e barnave të rimbursuara, protokollet e përdorimit të tyre dhe të gjitha aktet nënligjore të nevojshme për zbatimin e kontratës.
3. Të kontrollojë aktivitetin e Mjekut në zbatim të detyrimeve të kontratës.

Neni 6

Sanksionet

Për moszbatim të detyrimeve kontraktuale, palët kanë të drejtë të ushtrojnë këto sanksione:

- a) Neni 3, pikat 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 përcaktohet përgjegjësia individuale dhe merret masa administrative gjobë nga 1000 (një mijë) – 10.000 (dhjetë mijë) lekë, e përshkallëzuar në varësi të shkeljes).
- b) Neni 4, pikat 1, 2, 3, 5, 7 dhe 8 përcaktohet përgjegjësia individuale dhe merret masa administrative gjobë nga 1000 (një mijë) – 10.000 (dhjetë mijë) Lekë e përshkallëzuar në varësi të shkeljes).

- c) Neni 4, pikat 4 dhe 6 përcaktohet përgjegjësia individuale dhe vendoset detyrimi për shpërblim dëmi.

Neni 7

Ndërprerja e kontratës

Kontrata me Mjekun do të zgjidhet në menyrë të menjëhershme në keto raste:

1. Mjeku nuk pranon kontrollin apo inspektimin e Fondit/DRF.
2. Mjeku lëshon recetë fiktive, me qëllim përfitimi për vete ose në favor të të tretëve:
 - a. në emër të personave që nuk jetojnë.
 - b. në emër të personave të rremë.
 - c. në emër të personave që nuk kanë dijeni për lëshimin e recetës.
3. Është përjashtuar nga Urdhëri i Mjekut. Kontrata ndërpritet deri në riantarësimin në Urdhërin e Mjekut.
4. Kur Organizata Jofitimprurëse nuk zhvillon aktivitet.

Neni 8

Ankimi Administrativ

1. Subjekti ose personi përgjegjës ndaj të cilit është vendosur një sanksion sipas parashikimeve të kësaj kontrate, ka të drejtën e ankimit pranë Komitetit të Shqyrtimit Administrativ të Fondit, brenda 30 ditëve nga marrja në dijeni e vendimit me sanksionin përkatës.
2. Ankimi administrativ duhet të përmbajë këto elemente:
 - a. subjektin që ushtron ankimin me të dhënat identifikuese dhe adresën e tij;
 - b. procedurën konkrete për të cilën paraqitet ankimi;
 - c. një përshkrim të shkurtër të shkeljes së pretenduar dhe bazën ligjore përkatëse;
 - d. pretendimin e ankuesit për vendimin përfundimtar;
 - e. provat dhe dokumentacionin përkatës të cilat kërkohen të shqyrtohen nga Komiteti.
3. Komiteti i Shqyrtimit Administrativ shqyrton brenda 30 ditëve ankimin e paraqitur në përputhje me kërkesat e pikës 2 të këtij neni, por jo më vonë se afati i përfundimit të procedurës administrative.

4. Ankimi administrativ i paraqitur në përputhje me kërkesat e këtij neni, pezullon ekzekutimin e vendimit deri në vënien në dijeni të ankuesit me vendimin e Komitetit të Shqyrtimit Administrativ.
5. Kundër vendimit të Komitetit subjekti mund të ankohet në Gjykatën Administrative të Shkallës së parë.

Neni 9

Ndryshimet e kontratës

1. Kjo kontratë mund të ndryshojë vetëm me shkrim dhe me vullnetin, dhe pëlqimin e të dyja palëve.
2. Çdo ndryshim, shtesë ose shfuqizim i plotë ose i pjesshëm i kësaj kontrate nuk do të ketë fuqi nëse nuk është kryer me shkrim dhe nënshkruar nga të dyja palët kontraktues / përfaqësuesit e autorizuar të të dyja palëve.

Neni 10

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Palët kontraktuese respektojnë legjislacionin shqiptar në fuqi dhe përpiqen që mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë realizimit të kontratës, t'i zgjidhin me mirëkuptim midis tyre.
2. Pala që gjykon se ekziston një mosmarrëveshje, njofton palën tjetër duke bërë një përshkrim të plotë të çështjeve që kërkojnë zgjidhje.
3. Palët kontraktuese të përfshira në mosmarrëveshje duhet të bëjnë personaliasht apo nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar të tyre përpjekje për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, mbi parimin e ruajtjes së vazhdimësisë së punës.
4. Nëse palët kontraktuese apo përfaqësuesit e tyre të autorizuar nuk janë në gjendje të zgjidhin mosmarrëveshjen, brenda 14 (katërmëdhjetë) ditësh nga marrja e njoftimit apo për një kohë më të gjatë të miratuar nga palët, njëra palë njofton palën tjetër se çështja nuk është zgjidhur.
5. Për të gjitha mosmarrëveshjet që nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, organi kompetent është Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, ku ushtron aktivitetin.

Neni 11

Hyrja në fuqi

1. Kjo kontratë është përpiluar në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe secila nga palët mban nga 1 (një) kopje.
2. Kontrata pasi u lexua nga palët, u konsiderua e redaktuar sipas pëlqimit të tyre dhe u nënshkrua me vullnetin e tyre të lirë e të pavesuar.
3. Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët dhe i shtrin efektet e saj nga data 01.01.2024 deri në datën 31.12.2024. Ky afat mund të ndryshojë me miratimin e përbashkët me shkrim të palëve.

Kjo kontratë firmoset nga:

Për DREJTORINË RAJONALE TË FONDIT _____ / DEGA E FONDIT _____

..... Emri dhe firma e Drejtorit të DRF/DF

Mjeku pranë Organizatës Jofitimprurëse _____

Z/Znj. _____ me adresën _____.